



Kolegji AAB

**RREGULLORE PËR VLERËSIMIN E  
PERFORMANCËS SË STAFIT  
AKADEMIK**

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutit të Kolegjit AAB, Senati në mbledhjen e mbajtur me 17/12/2021 miraton këtë:

## RREGULLORE PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCES SË STAFIT AKADEMIK

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik mbështetet në Statutin e Kolegjit AAB dhe plotëson dispozitat e tij.

#### **Neni 2**

Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë stafin e rregullt akademik të Fakulteteve.

#### **Neni 3**

### **Qëllimi**

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kriteret, periudhën kohore, llogaritjen e rezultateve të vlerësimit, si dhe masat që ndërmerrën pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të performancës së stafit të rregullt akademik.

#### **Neni 4**

### **Qëllimi i vlerësimit të performancës**

1. Vlerësimi i performancës së stafit të rregullt akademik ka për qëllim ngritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe shkencor, përmirësimin e efektivitetit të punës dhe motivimin e stafit akademik.

2. Përmes vlerësimit të performancës, stafi akademik:

- 2.1. informohet saktësisht për atë çfarë pret institucioni prej tyre;
- 2.2. është i informuar me kohë për cilësinë e punës së vet, përfshirë sukseset, kërkosat dhe vështirësitë në realizimin e detyrave të tyre;
- 2.3. përfiton nga mundësitë për trajnim, aftësim dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional; dhe
- 2.4. shpërblehet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për performancë të mirë.

## **Neni 5**

### **Vlerësimi i performancës së stafit akademik**

1. Vlerësimi i performancës së stafit akademik bëhet përmes:

- a) vlerësimit nga studentët,
- b) vlerësimit nga mbikëqyrësi,
- c) vet vlerësimit, dhe
- d) vlerësimi nga kolegu.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi nga studentët**

1. Vlerësimi nga studentët, realizohet dy herë brenda vitit akademik përmes pyetësorëve anonim.

2. Pyetësorët për student administrohen nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë përmes sistemit elektronik për menaxhimin e procesit mësimor e-service.

3. Me përfundimin e ligjëratave në semestrin dimëror, përkatësish semestrin veror, para fillimit të afatit të regjistrimit të provimeve, Zyra e Sigurimin e Cilësisë aktivizon pyetësorin elektronik i cili plotësohet nga secili student për secilin pjesëtarë të stafit akademik për lëndën e ndjekur.

4. Pyetësori për vlerësim nga ana e studentit përbëhet nga tri shtylla kryesore të cilat adresojnë strukturën dhe respektimin e përbajtjes së syllabusit, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit dhe aspektin e menaxhimit dhe organizimit të procesit mësimor.

5. Pesha maksimale e vlerësimit të tërësishëm të mësimdhënësit nga ana e studentit për një semestër është 15%, përkatësish 30% për të dy vlerësimet semestrale.

## **Neni 7**

### **Vlerësimi nga mbikëqyrësi**

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë që bënë vlerësimin e stafit akademik është Dekani i Fakultetit.

2. Vlerësimi nga mbikëqyrësi realizohet një herë brenda vitit akademik dhe përfshinë elementet si në vijim:

- Kontributi shkencor
- Procesi mësimor
- Kontributi për fakultetin
- Zhvillimi i projekteve
- Angazhimi në komunitet

3. Kontributi shkencor i stafit akademik vlerësohet përmes publikimit të punimeve shkencore në përputhje me rregullat e vendosura për avancim akademik, dhe përfshin publikimin në revista të indeksuara, pjesëmarrjen në konferanca shkencore dhe botimin e librave.

4. Procesi mësimor përfshin respektimin e orarit të ligjëratave, ushtrimeve, provimeve, konsultimeve me student; përgatitja e materialeve dhe publikimi i tyre në platformën elektronike e-service; angazhimi i profesorit për sjelljen e stafit vizitor; si dhe realizimi i aktiviteteve jashtë kurrikulare me student që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së procesit mësimor.

5. Kontributi për fakultetin përfshin angazhimin e rregullt të profesorit të trupat akademike, pjesëmarrjen në takimet e rregullta të Këshillit Mësimor, Komisioneve brenda Fakultetit, angazhimin në grupe punuese dhe procese të tjera që ndërlidhen me zhvillimin e programeve të studimit dhe të fakultetit.

6. Zhvillimi i projekteve përfshin angazhimin e profesorit në hartimin, udhëheqjen dhe implementimin e projekteve, të karakterit vendor apo ndërkombëtarë, të cilat financohen nga AAB apo nga burime të jashtme të financimit.

7. Angazhimi në komunitet përfshin angazhimin e profesorit në aktivitetet të cilat janë në të mirën e përgjithshme të komunitetit dhe shoqërisë në tërësi.

8. Vlerësimi përbledhës i të gjitha komponentëve të mësipërme nga dekani bëhet në fund të semestrit veror, përkatësisht në muajin korrik të vitit përkatës.

9. Vlerësimet e të gjitha komponentëve të mësipërme regjistrohen në platformën elektronike e-service nga Dekani.

10. Pesha maksimale e tërësisë së vlerësimeve të mësipërme është 50%, përkatësisht 25% për kontributin shkencor, 10% për procesin mësimor, 5% kontributi për fakultetin, 5% zhvillimi i projekteve dhe 5% angazhimi për komunitetin.

## **Neni 8**

### **Vlerësimi nga kolegu**

1. Vlerësimi nga kolegu realizohet në formë të vizitës së kolegut në orën mësimorë të profesorit i cili vlerësohet.
2. Përcaktimi i kolegut vlerësues bëhet në fillim të vitit akademik përmes një shorti në mbledhjen e parë të Këshillit Mësimor të Fakultetit.
3. Secili mësimdhënës është vlerësues dhe i vlerësuar së paku një herë brenda vitit akademik.
4. Çështje të cilat vlerësohen kanë të bëjnë me aspektet organizative dhe metodologjike të organizmit të orës nga ana e profesorit.
5. Vlerësimi bëhet në bazë të formularit për vlerësim i cili regjistrohet në platformën elektronike e-service.
6. Pesha maksimale e vlerësimit nga kolegu është 10%.

## **Neni 9**

### **Vetëvlerësimi**

1. Vetëvlerësimi realizohet nga secili profesor përmes plotësimit të formularit të standardizuar për vetëvlerësim për përbushjen e detyrave të tij.
2. Formulari plotësohet në fund të semestrit veror, përkatësisht në muajin korrik, përmes platformës elektronike e-service.
3. Pesha maksimale e vetëvlerësimit është 10%.

## **Neni 10**

### **Rezultati përfundimtarë i vlerësimit**

1. Pas mbledhjes së të gjitha komponentëve të vlerësimit, në sistemin elektronik gjenerohet numri i pikëve të grumbulluara për secilin komponentë, dhe pikët totale.
2. Në bazë të pikëve të grumbulluara, vlerësimi mund të kategorizohet në:

- 2.1. vlerësim i mirë >70%
- 2.2. vlerësim mestarë 50-70%
- 2.3. vlerësim i dobët <50%.

## **Neni 11**

### **Ndërmarrja e masave**

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të performancës së stafit akademik, Zyra e Cilësisë identifikon fushat e intervenimit në bazë të rezultateve të vlerësimit dhe rekomandon për nevojat e intervenimit.
2. Në rast se rezultati i vlerësimit të një profesori është mesatar, profesorit i rekomandohet fokusimi në disa prej komponentëve në të cilat është vlerësuar dobët.
3. Në rast se rezultati i vlerësimit është i dobët, hartohet një plan i përmirësimit dhe profesori obligohet në ndjekjen e trajnimeve përfundimtare qëndrore.
4. Në rast se profesori, edhe pas ndjekjes së trajnimeve sipas planit të përmirësimit, merr vlerësim të dobët edhe në herën e dytë, atëherë Dekani i Fakultetit rekomandon Rektorit që ndaj të njëjtit të merren masat si në vijim:

- 1.1. vërejtje me shkrim;
  - 1.2. zbritje e normës së mësimdhënies;
  - 1.4. ndalimi i mentorimit të temave të kandidatëve;
  - 1.5. masa të tjera ta parapara me Statut.
2. Në rast se profesori merr vlerësim të dobët tri herë radhazi, atëherë Dekani i Fakultetit i rekomandon Rektorit ndërprerjen e marrëdhënies së punës me profesorin.

## **Neni 12**

### **Ankesa**

1. Stafi akademik i pakënaqur me vlerësimin e përformancës dhe pikët e grumbulluara, nëse arrin të dëshmoj se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar drejtë dhe rezultati përmban të dhëna të pasakta, ka të drejtë të kërkoj rivlerësim në pjesën ku ka vërejtje.

2. Dekani i Fakultetit vendos për kërkesën për rivlerësim, dhe në rast të refuzimit, vendimi i dekanit duhet të jetë i arsyetur mirë.
3. Kundër vendimit të dekanit që vendos për kërkesën për rivlerësim, staf akademik brenda afatit 7 ditor, ka të drejtë ankesë në Komisionin e Studimeve.
4. Staf akademik i pakënaqur me masat e shqiptuara nga Rektori sipas nenit 11, mund të paraqesë ankesë me shkrim në shkallë të parë tek Komisioni i Studimeve, brenda afatit 7 ditor nga pranimi i vendimit.
5. Kundër vendimit të Komisionit të Studimeve, profesori ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues.

#### **Dispozitat përfundimtare**

##### **Neni 13**

Në rast se dispozitat e kësaj Rregullore bien në kundërshtim me dispozitat e Statutit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

##### **Neni 14**

Rregullorja për Vlerësimin e Performances së Stafit Akademik mund të ndryshohet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të saj.

##### **Neni 15**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.



**Paraqitja në formë tabelore e kritereve të vlerësimit**

<b>Forma</b>	<b>Elementet</b>	<b>Periudha kohore</b>	<b>Përqindja</b>	<b>Totali i %</b>
<b>Vlerësimi nga studentët</b>	Syllabusi, format e vlerësimit, metodologjia e mësimdhënies, angazhimi i studentit në klasë, sigurimi i literaturës, ofrimi i sqarimeve dhe konsultimet	Dy here në vit, pas përfundimit të semestri dimëror Pas përfundimit të semestrat veror	15% vlerësimi i parë 15% vlerësimi i dytë	30%
<b>Vlerësimi nga mbikëqyrësi</b>	Punimet shkencore Pjesëmarra në konferenca shkencore Angazhimi në komunitet dhe zhvillim të projekteve	Një herë në vit, pas përfundimit të semestrat veror	25% kontributi shkencor 10% procesi mësimor 5% kontributi për fakultetin 5% zhvillimi i projekteve 5% angazhimi në komunitet	50%
<b>Vlerësimi nga kolegu</b>	Realizimi i syallbusit Qasja e mësimdhënies apo e vlerësimit Komunikimi me student Angazhimi i studentëve në klasë	Një herë në vit, gjatë gjithë vitit		10%
<b>Vetvlerësimi</b>	Përbushja e detyrave të vendosura në fillimin e vitit akademik nga vet stafi	Një herë në vit, pas përfundimit të semestrat veror		10%
				<b>100%</b>





# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale Prishtinë-Fushë  
Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 1324 /2021 Prishtinë, 17.12.2021


Senati i Kolegit AAB, në mbledhjen e mbajtur më 17.12.2021 mori këtë:

## V E N D I M

1. MIRATOHET Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Sekretarit
3. Dekanëve

  
Dr. sc. Bujar Demjaha, Rektor

